

Universiteti i Evropës Juglindore shpall:

K O N K U R S

Për zgjedhje/rizgjedhje të mësimdhënësve në thirrjen Profesor Inordinar i titulluar dhe Docent i titulluar

FAKULTETI I BIZNESIT DHE EKONOMISË

Zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në thirrje të titulluar – Docent i titulluar për lëndë nga fusha e Financave dhe Sistemit Bankar;

FAKULTETI I SHKENCAVE DHE TEKNOLOGJIVE BASHKËKOHORE

Zgjedhje/rizgjedhje të një mësimdhënësi në thirrje të titulluar – Profesor Inordinar i titulluar për lëndë nga fusha e Edukimit Mjedisor;

II. Përveç kushteve të përgjithshme të parapara në Ligjin e arsimit të lartë të R. Maqedonisë, Statutit dhe Rregullores për zgjedhje apo rizgjedhje në thirrje mësimore shkencore, thirrje bashkëpunëtori dhe thirrje mësimore profesionale të UEJL, kandidatët duhet t'i plotësojnë edhe kushtet si vijojnë:

- Për të gjitha vendet preferohet njohja e gjuhës shqipe, maqedonase dhe angleze, kurse njohja e së paku dy nga gjuhët e përmendura në nivel akademik /për mësimdhënie/, është e obligueshme.
- Formularin e plotësuar për aplikim të UEJL;
- Letër interesi që tregon përvojën e kandidatit, agjendën e hulumtimit dhe aspiratat për karrierë në përputhje me strategjinë e fakultetit;
- Biografinë e plotë akademike;
- Dy letra rekomandimi. Njëra të jetë nga një akademik/hulumtues ndërkombëtar që ka njohuri për veprimtarinë e kandidatit;
- Dëshmi për përsosmëri në mësimdhënie përfshi por, jo edhe të kufizohemi vetëm në pikët në vazhdim: 1) raportet nga vëzhgimi i mësimdhënies; 2) vlerësimin nga studentët për lëndët; 3) raport nga vëzhgimi kolegial për mësimdhënien;,etj.
- Dëshmi për përsosmëri në hulumtim përsbi edhe 1) kopje të plota të publikimeve të fundit kryesore në revistat rajonale dhe ndërkombëtare; 2) fotokopje nga kaptinat e librave, recensione akademike; 3) kopje të monografive, librave universitar, etj.
- Përkthimet nga gjuhët evropiane në gjuhët lokale;

- Dëshmi për shërbimet përfshi listën e anëtarësimit në komitete, organe dhe veprimet, etj.
- Dëshmi për hulumtim/praktikë në metodologji dhe pedagogji, duke përfshirë çdo certifikatat ose dëshmi për përfundim të suksesshëm të kurseve, programeve apo trajnime për mësimdhënie apo publikimet shkencore në këtë fushë.

III. Fillimi, mbarimi dhe orari i kohës së punës dhe shuma e rrogës (ne shume neto: 39,975 - 52,275 denar) për mësimdhënësit është e ndryshueshme dhe përcaktohen ne pajtim me aktet e Universitetit sipas orarit te mësimdhënies dhe angazhimit të mësimdhënësit në mësimdhënie ne semestër dhe thirrjes mësimore-shkencore në të cilën është realizuar zgjedhja.

IV. Për të aplikuar në këtë konkurs, kandidatët duhet të dërgojnë (vetëm përmes e-mailit): letërinteresim, biografi personale (CV), dhe formularin për aplikim (merret në ueb faqen e universitetit).

Diplomë (doktoraturë), listë për veprimtarinë profesionale dhe shkencore dhe nga një kopje të recensionit të parë (nëse posedojnë), të gjitha këto dokumente të theksohen në formularin për dëshmi të dokumentacionit të dorëzuar, që mund të merret në ueb faqen e universitetit, ndërsa do të dorëzohen pas seleksionimit të kandidatëve që i plotësojnë kushtet)

Dokumentet e mësipërme mund të jenë origjinale ose të vërtetuara në noter.

V. Afati i paraqitjes

Afati i dorëzimit të aplikacioneve është **15 ditë** nga dita e shpalljes së konkursit.

Konkursi është i shpallur nga 18.09.2013 – 02.10.2013

Aplikimet vetëm përmes e-mailit: jobs@seeu.edu.mk (Aplikacion valid do konsiderohet vetëm aplikacioni i plotësuar që gjendet në ueb faqen e Universitetit, në rubrikën Konkurse. Çdo lloj tjetër forme aplikacioni nuk do merret parasysh).

VI. Adresa

Universiteti i Evropës Juglindore

Zyra e Burimeve Njerëzore

Bul. "Ilinden" nr. 335

1200 Tetovë, Maqedoni

Telefoni për kontakt: 044 356 087